



**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**"ORIALBA" SH.P. K**

Sot, më date 30/03/2023 (Dymijenzjetetë) para meje Noterit Florian Hoxha, Antar në Dhomen Kombëtare të Noterisë. Dega Vendore Durres, me Zyre në adresën Durres, Nr.11, "Aleksander Goga", Nr.641, Nr.27

**U PARAQITEN**

Znj. Meneghin Maria Antonietta, qytetare italiane, lindur në Arzergrande (PD)-Itali me date 27/05/1952, dhe banuese në Via Madonna 9 - Terrassa Padovana (PD)-Itali, qytetare italiane, madhore dhe me zotësi të plote për të vepruar, me numer identifikimi karta identitetit CA00227DC, në cilësinë e Perfaqësuesit ligjor të Shoqërisë "CALZATURIFICIO ORION S.P.A." me seli në Rrugen Industria, 4-35023 Bagnoli di Sopra(PD), me Kapital Social Euro 1.000.000, me Kod Fiskal dhe Nr. Regjistrimi në Regjistrin e Siperpërmendur të Padoves(PD) me no. 02018450284, REA-PD-197834

Pala e sipërpërmendur kërkon që unë të marr këtë akt për krijimin e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në të cilin parashikohet si më poshtë:

**Neni 1**

Personi i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe me liri të plotë veprimi, në bazë të ligjeve shqiptare, themelojnë Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) të emërtuar: **"ORIALBA" SH.P. K**

Shoqëria do të administrohet nga një Këshill Administrimi i përbërë nga tre Administratorë:

- Nga Znj Meneghin Maria Antonietta, e datëlindjes 27/05/1952 në Arzergrande (PD) - Itali dhe banuese në Via Madonna 9 - Terrassa Padovana (PD) - Itali me kartë identiteti italian nr. CA00227DC, e cila emërohet **Presidente e Keshillit të Administrimit** për një periudhë 5-vjeçare;
- Nga Z. Nicola Sgamma, i datëlindjes 25.11.1960, lindur në Barletta-Itali dhe me banim në Vlore Rruga 28, Nentori, dhe kartë identiteti italiane Nr. AT9646354 i cili

Formonohet Keshilltar i Keshillit te Administrimit per një periudhë 5-vjeçare .

Nga Z. Erion Çimo, i datelindjes 15.06.1980, banues ne Durres me nr karte identiteti I00615073N , i cili emerohet Administrator i deleguar per një periudhë 5-vjeçare.

Shoqëria ka të drejtën të krijojë filiale brenda dhe jashtë vendit në çdo moment që do të konsiderohet i përshtatshëm nga ana e saj dhe me aprovimin e organeve kompetente (Qendra Kombëtare e Regjistrimeve).

## Neni 2

Shoqëria gëzon statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas pikave të paraqitura në këtë akt themelimi, statutit të saj dhe ligjeve në fuqi.

Selia e saj do të jetë në adresen:

DURRES Lagjja 15, Spitalle, Zona Kadastrale 8514, Kapanon 1 katësh, Nr.Pasurie 104/14

Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë integrale e tij.

## Neni 3

Aktiviteti i shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e aktit të themelimit nga ana e organeve shtetërore kompetente dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore më të gjatë se 10 vjet, me përjashtim te shpërbërjes ose zgjatjes së parakohshme.

## Neni 4

Shoqëria ka si objekt zhvillimin e aktiviteteve sic pershkruhen me poshte:

-Prodhimi i këpucëve dhe pjesëve të këpucëve të çdo lloji (sportive, ecjeje, pushimi, ortopedike,faqeve etj.) dhe të çdo materiali (lëkurë, lëkure, plastikë, gome,sintetike etj.) si dhe elementeve aksesore të tyre.

-Tregtimi, Import- eksport në të gjitha format e lejuara ligjërisht te artikujve te pershkruar më sipër.

-Aktivitet ne fushen e regjimit te perpunimit aktiv(Fason).

-Kryerjen e transaksioneve tregtare dhe industriale, financiare, hipotekore dhe të pasurive të paluajtshme, duke përfshirë blerjen, shitjen dhe shkëmbimin e



pasurive të luajtmshme e të paluajtmshme, përfshirë pronën e regjistruar, të paluajtmshme dhe të drejtat pronësore, dhënien me qira të pasurive të luajtmshme dhe të paluajtmshme, me përjashtim të qirave financiare;

- T'i drejtohet çdo forme financimi (si dhe leasing pasiv) me Institucione Kreditore, banka, shoqëri dhe individë, duke dhënë garancitë e duhura reale dhe personale;

- Dhënien e garancive, miratime dhe garanci reale në favor të shoqërive mëmë, filialeve dhe shoqërive të lidhura, dhe në çdo rast brenda të njëjtit grup, në zbatim të legjislacionit aktual për këtë temë;

- Marrjen pjesë në konsorciume ose grupime biznesi dhe shoqata të përkohshme biznesi;

- Të marrë përsipër aksione dhe interesa në kompani dhe biznese në përputhje me dispozitat rregullatore dhe për këtë arsye me qëllimin e vetëm të arritjes së qëllimeve të korporatës, në mënyrë jo ekskluzive.

-Shoqëria mund të përdorë përfitimet financiare, të sigurimeve shoqërore dhe financiare të parashikuara nga ligjet aktuale, ndryshimet dhe shtesat e tyre, për veprimtarinë në fjalë dhe nga çdo ligj tjetër lehtësues, si dhe lehtësimet e parashikuara për Komunitetin Europian.

#### Neni 5

Kapitali i kësaj Shoqërie do të jete **100.000 leke** (njëqindmije)leke, i ndarë në nje kuote.Kontributi i Ortakut ne kapitalin e Shoqerise eshte si me poshte:

**Shoqëria "CALZATURIFICIO ORION S.P.A."** me seli ne Rrugen Industria, 4-35023 Bagnoli di Sopra(PD), me Kod Fiskal dhe Nr. Regjistrimi ne Regjistrin e Siper marrjeve te Padoves(PD) me no. 02018450284, REA PD-197834 eshte zoteruese e 1(nje) kuote me 100% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise.Kuota ka nje vlere nominale 100.000 leke

#### Neni 6

Fitimi neto që do të përfitohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie, nëse shpërndahet, do t'u kalohet ortakeve sipas kuotave të zotëruara në kapitalin social. Për rrjedhojë, me regjistrimin e këtij akti në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ortakut nuk do të ketë asnjë përgjegjësi për detyrimet e kontraktuara nga shoqëria, përveçse brenda kufijve të aseteve të shoqërisë. Nëse shoqëria ka një ortak



të vetëm, komunikimi në përputhje me art. 71 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të lerohet nga ky i fundit.

#### Neni 7

Për detyrimet ndaj të tretëve që do të krijohen gjatë aktivitetit, shoqëria do të përgjigjet ekskluzivisht vetëm me kapitalin e saj. Për rrjedhojë, ortakët nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për detyrimet e krijuara nga shoqëria, përveçse brenda kufijve të kapitalit të vetë shoqërisë.

#### Neni 8

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri dhe filialet e saj rregullohen përmes kontratave specifike.

#### Neni 9

Dispozita më të thelluara mbi organizimin e kësaj shoqërie janë të specifikuar në statutin e shoqërisë. Themeluesja e shoqërisë e ka lexuar këtë akt themelimi, e ka konsideruar të pranueshëm ndaj vullnetit të tij dhe e ka firmosur pa kundërshtime.


### ORTAKU I SHOQERISE

Shoqëria

"CALZATURIFICIO ORION S.P.A."

Perfaqesuar nga

Meneghin Maria Antonietta


Përkthues

Arda Gruçka



STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ORIALBA" Sh.p. k

KREU I (THEMELIMI-EMRI - QËLLIMI - KOHËZGJATJA - SELIA)

Neni 1 - Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 30.03.2023 në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Ortaku i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar,

me emrin "ORIALBA" SHPK, formulon Statutin e saj, si më poshtë vijon:

Ortaku i Shoqërisë është:

SHOQERIA "CALZATURIFICIO ORION S.P.A." me seli ne Rrugen Industria, 4-35023 Bagnoli di Sopra(PD) , me Kapital Social Euro 1.000.000, me Kod Fiskal dhe Nr. Regjistrimi ne Regjistrin e Sipermarrjeve te (PD) me no. 02018450284, perfaqesuar nga Perfaqesuesi ligjor i Shoqerise Znj. Meneghin Maria Antonietta, lindur ne Arzergrande (PD)-Itali me date 27/05/1952, dhe banuese ne Via Madonna 9 - Terrassa Padovana (PD)-Itali, qytetare italiane, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer identifikimi karta identitetit CA00227DC

**Neni 2 - Selia dhe vendbanimi i ortakut**

2.1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën:

DURRES Spitallë, Lagjja 15 Zona Kadastrale 8514, Kapanon 1 katësh, Nr.Pasurie 104/14





Shoqëria, në përputhje me ligjin, mund të krijojë filiale, degë, agjenci, përfaqësi, magazina, adresa dhe zyra si brenda dhe jashtë vendit.

2.3. Vendbanimi i ortakut, për sa i përket marrëdhënieve me shoqërinë, është ai që rezulton nga akti i themelimit, ose i fundit i komunikuar shoqërisë.

### **Neni 3 - Objekti i aktivitetit i Shoqërisë**

Shoqëria ka si objekt aktivitetet si me poshte te specifikuara:

- Prodhimi i këpucëve dhe pjesëve të këpucëve të çdo lloji (sportive, ecjeje, pushimi, ortopedike, etj.) dhe të çdo materiali (lëkurë, plastikë, gome, sintetike, etj.) si dhe elementeve aksesorë të tyre.
- Tregtimi, Import- eksport në të gjitha format e lejuara ligjërisht te artikujve te pershkruar më sipër.
- Aktivitet ne fushen e regjimit te perpunimit aktiv (Fason).
- Kryerjen e transaksioneve tregtare dhe industriale, financiare, hipotekore dhe të pasurive të paluajtshme, duke përfshirë blerjen, shitjen dhe shkëmbimin e pasurive të luajtshme e te paluajtshme, përfshirë pronën e regjistruar, të paluajtshme dhe të drejtat pronësore, dhënien me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, me përjashtim të qirave financiare;
- T'i drejtohet çdo forme financimi (si dhe leasing pasiv) me Institucione Kreditore, banka, shoqëri dhe individë, duke dhënë garancitë e duhura reale dhe personale;
- Dhënien e garancive, miratime dhe garanci reale në favor të shoqërive mëmë, filialeve dhe shoqërive të lidhura, dhe në çdo rast brenda të njëjtit grup, në zbatim të legjislacionit aktual për këtë temë;
- Marrjen pjesë në konsorciume ose grupime biznesi dhe shoqata të përkohshme biznesi;
- Të marrë përsipër aksione dhe interesa në kompani dhe biznese në përputhje me dispozitat rregullatore dhe për këtë arsye me qëllimin e vetëm të arritjes së qëllimeve të korporatës, në mënyrë jo ekskluzive.

Shoqëria mund të përdorë përfitimet financiare, të sigurimeve shoqërore dhe financiare të parashikuara nga ligjet aktuale,





ndryshimet dhe shtesat e tyre, për veprimtarinë në fjalë dhe nga  
çdo figj tjetër lehtësues, si dhe lehtësimet e parashikuara për  
Komunitetin Europian.

#### **Neni 4 - Kohëzgjatja e shoqërisë**

4.1. Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet më shumë se 10 (dhjete)  
vjet, me përjashtim të shpërbërjes së parakohshme të vendosur  
nga mbledhja e ortakeve.

### **KREU II**

#### **KAPITALI I SHOQERISE DHE PJESMARRJA E ORTAKEVE**

#### **Neni 5 - Kapitali i shoqërisë, tarifatat e pjesëmarrjes.**

5.1. Kapitali shoqërisë është 100.000 (njqindmije) leke dhe  
ndahet në 1-nje kuote si është percaktuar ne aktin e themelimit;  
mund të rritet ose të zvogëlohet me vendim të caktuar të  
mbledhjes së ortakeve dhe kontributet mund të bëhen edhe në  
natyrë ose në kredi.

5.2. Të drejtat sociale u takojnë ortakeve në përpjesëtim me  
kuotave që zotëron secili ortak.

#### **Neni 6 - Transferimi i kuotave**

6.1. Në rast të vdekjes së një prej ortakeve, mbledhja e  
ortakeve do të duhet të vendosë nëse do të pranojë  
trashëgimtarët si ortake ose nëse do të likujdojë kuotat e tyre  
në një vlerë të barabartë me kapitalin neto që rezulton nga  
pasqyrat financiare të miratuara të fundit.

6.2. Nga ana tjetër, kalimi i kuotave ndërmjet individëve të  
gjallë mund të bëhet në favor të subjekteve për të cilat  
mbledhja e ortakeve, me shumicën e kapitalit të shoqërisë, ka  
dhënë miratimin e saj.

6.3. Pasi ortaku që synon t'ua shesë kuotat e tij palëve të  
treta, jo ortakeve, ka marrë miratimin e mbledhjes së ortakeve,  
ai duhet t'ua ofrojë kuotat për shitje në kushte të barabarta  
ortakeve të tjerë të shoqërisë në proporcion me kuotën që  
zotëron. nga secili, duke u dhënë atyre një të drejtë  
parablerjeje të ushtruar brenda 30 ditëve nga komunikimi i  
ofertës.

6.4 Kalimi i kuotave duhet të bëhet me akt noterial.



**KREU III**  
**VENDIMET DHE MBLEDHJET E ORTAKEVE**

**Neni 7 - Vendimet e ortakeve**

7.1. Në bazë të nenit 82 të ligjit 9901, datë 14.04.2008, aksionarët vendosin me anë të Asamblesë së Përgjithshme (në tekstin e mëtejshëm "Mbledhja e ortakeve") në rastet e parashikuara nga ligji dhe sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërinë, dhe në veçanti në bazë të këtij statuti, për çështjet e mëposhtme të rezervuara për kompetencën e tyre:

- ndryshimet në Statut;
- vendimet për të kryer operacione që përfshijnë një modifikim të qëllimit të korporatës ose një modifikim të të drejtave të ortakeve;
- vendimet në lidhje me ndarjen e fitimeve;
- emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- miratimi i pasqyrave financiare;
- likuidimin e shoqërisë;
- çdo vendim tjetër për të cilin të paktën një nga drejtorët kërkon zgjidhjen e ortakeve.

7.2. Në bazë të artit. 88 të ligjit 9901, datë 14.04.2008, mbledhjet mund të zhvillohen edhe me audio-videokonferencë ose audio-konferencë vetëm për sa kohë që sigurohen të drejtat e mëposhtme të pjesëmarrjes:

- 1) duhet të zgjidhet vendi i mbledhjes ku të paktën janë të pranishëm kryetari dhe sekretari i mbledhjes;
- 2) duhet të lejohet identifikimi i saktë i personave që kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhje;
- 3) secili duhet të lejohet të flasë me gojë për të gjitha temat, si dhe të jetë në gjendje të shikojë ose të marrë dokumentacion dhe të jetë në gjendje ta transmetojë atë në kohë reale. Ekzistenca konkrete e të drejtave të sipërpërmendura të pjesëmarrjes duhet të konstatohet nga Kryetari i mbledhjes, i cili duhet ta njohë atë në procesverbalin përkatës.

7.3. Në rast se takimi do të mbahet me audio-video-konferencë ose audio-konferencë, njoftimi i thirrjes duhet të tregojë kohën e fillimit të lidhjes telematike dhe vendndodhjet e konferencës audio-video të lidhura nga kompania në të cilën pjesëmarrësit mund të bien dakord: raporti i pjesëmarrjes duhet të hartohet në çdo vend takimi.





**Neni 8 - Efektiviteti i vendimeve të mbledhjes së ortakeve**

8.1. Mbledhjet e mbledhura dhe të konstitutara rregullisht përfaqësojnë universalitetin e ortakeve dhe vendimet e marra në përputhje me ligjin dhe me këtë akt detyrojnë të gjithë ortaket, edhe nëse mungojnë ose nuk janë të mendimit, pa cenuar të drejtën e tërheqjes kur parashikohet me ligj.

**Neni 9 - Vendi dhe thirrja e mbledhjes Asamblese**

9.1. Mbledhja e ortakeve, e cila mund të zhvillohet si në selinë e regjistruar ashtu edhe gjetkë, do të thirret nga organi administrativ me anë të një njoftimi dërguar ortakeve, drejtorëve dhe anëtarëve të organit të kontrollit, nëse caktohet, të paktën shtatë ditë përpara datën e caktuar për mbledhjen në adresën që çdo palë e interesuar do t'i ketë komunikuar shoqërisë.

9.2. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë shënimin e ditës, orës dhe vendit të mbledhjes, si dhe temat për të cilat thirret mbledhja për të diskutuar.

9.3. Në të njëjtin njoftim, mbledhja e dytë mund të caktohet për një ditë tjetër në rast se e para është braktisur ose nuk mund të konstituohet rregullisht.

9.4. Në bazë të nenit 83 të ligjit 9901, datë 14.04.2008, njoftimi duhet të hartohet me shkrim me të drejtë njoftimi me e-mail dhe mund të dërgohet me çdo sistem komunikimi, për aq kohë sa është i përshtatshëm për të siguruar dëshmi e marrë. Në çdo rast, mbledhjet që nuk janë thirrur siç duhet, konsiderohen të vlefshme kur kanë marrë pjesë të gjithë ortaket.

**Neni 10 - Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në Asamble**

10.1. Në mbledhjen e Asamblese mund të marrin pjesë të gjithë ata që paraqiten si ortake në datën e mbledhjes.

10.2. Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një përfaqësues me shkrim i dhënë, gjithashtu me faks ose e-mail, një personi tjetër, goftë edhe një jo ortak.

10.3. Autorizimi nuk mund të lëshohet bosh.

**Neni 11 - Presidenti Asamblese**

11.1. Mbledhja Asamblese drejtohet nga Administratori, ose nga Presidenti i Keshillit Administrimit, në rast të emërimit të një organi kolegjial, ose në rast të mungesës së tyre, nga një person tjetër i caktuar nga Asambleja.



11.2. Për të arritur këtë përcaktim të fundit, mbledhja do të drejtohet përkohësisht nga personi më i vjetër i pranishëm në mbledhje të Asamblese.

11.3. Asambleja zgjedh sekretarin, i cili mund të jetë edhe jo ortak ose punonjës i shoqërisë dhe, nëse është e nevojshme, dy kontrollues.

11.4. Në bazë të artit. 90 i ligjit 9901, datë 14.04.2008, vendimet e asamblesë së ortakeve duhet të regjistrohen në procesverbal të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari; në rastet e përcaktuara me ligj procesverbali duhet të përpilohet nga noteri.

11.5. Presidenti Asamblese verifikon rregullsinë e konstituimit të Asamblese, konstaton identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, rregullon ecurinë, konstaton rezultatet e votimeve.

#### **Neni 12 - Kuorumi themelues dhe këshillues i Asamblesë**

12.1. Në bazë të nenit 86 të ligjit 9901, datë 14.04.2008, mbledhja konstituohet në mënyrë të rregullt me praninë e shumë ortakeve që përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë. Në rastet e parashikuara nga neni 87 i ligjit 9901, datë 14.04.2008 dhe kjo për vendimet që kanë të bëjnë me ndryshimin e Statutit, veprimet e rritjes dhe zvogëlimit të kapitalit, shpërndarjen e fitimeve dhe rreorganizimin ose shpërbërjen të shoqërisë, mbledhja konstituohet në rregull vetëm me praninë e shumë ortakeve që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë. Nëse nuk arrihet kuorumi i parashikuar në nenin e mëparshëm, mbledhja duhet të mbledhet sërish brenda 30 ditëve.

12.2. Me përjashtim të rasteve kur ligji ose aktet nënligjore parashikojnë ndryshe, mbledhja e formuar siç duhet, vendos me votën pro të shumicës së ortakeve.

12.3. Për më tepër, për vendimet e parashikuara nga neni 87 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 zgjidhet asambleja e ortakeve, me votën e më shumë se 75% të ortakeve.

#### **KREU IV**

#### **ADMINISTRIMI - PËRFAQËSIMI SHOQËROR**

#### **Neni 13 - Administrimi i Shoqërisë**

13.1. Në bazë të artit. 95 i ligjit 9901, datë 14.04.2008 shoqëria do të administrohet, ashtu si do të parashikohet nga koha në kohë nga Asambleja e ortakeve, nga një Administrator ose nga një Këshill Administrimi që do të nominohet për një kohëzgjatje prej 5 (pese) vitesh, të cilët mund të mos jenë

Ortaket. Shoqëria do të Administrohet nga një Keshill  
Administrimi i përbërë 3 anëtarë si më poshtë:

- Znj **Meneghin Maria Antonietta**, e datëlindjes 27/05/1952 në Arzergrande (PD) - Itali dhe banuese në Via Madonna 9 - Terrassa Padovana (PD) - Itali me kartë identiteti italian nr. CA00227DC e cila emërohet **Presidente e Keshillit të Administrimit** për një periudhë 5-vjeçare;

- **Z. Nicola Sgamma**, i datëlindjes 25.11.1960, në Barletta-Itali dhe me banim në Vlore Rruga 28, Nentori, dhe kartë identiteti italiane Nr. AT9646354 i cili emërohet **Keshilltar i Keshillit të Administrimit** për një periudhë 5-vjeçare.

-**Z. Erion Çimo**, i datëlindjes 15.06.1980, banues në Durrës me nr kartë identiteti I00615073N, i cili emërohet **Administrator i deleguar për një periudhë 5-vjeçare**.

13.2. Mandati i Administratoreve është i rinovueshëm. Në çdo rast, në çdo kohë, pra edhe para afatit të përfundimit, drejtorët mund të revokohen edhe pa një shkak të drejtë .

13.3. Shpërblimi dhe pjesëmarrja në fitimet që i takojnë Administratorit dhe anëtarëve të Keshillit të administrimit caktohen nga ortaket.

13.4. Administratori ose anëtarët e Keshillit të administrimit kanë gjithashtu të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra për arsye të funksionit të tyre.

13.5. Shpërblimi i Administratoreve të ngarkuar me funksione të veçanta dhe, në çdo rast, të çdo Administratori të deleguar, përcaktohet nga Keshilli i Administrimit.

#### **Neni 14 - Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe Administratori i deleguar**

14.1. Në rast të emërimit të një Keshilli Administrimi, nëse nuk e kanë bërë këtë ortaket, i njëjti zgjedh nga radhët e anëtarëve të tij një President dhe një nënpresident të cilët zëvendësojnë Presidentin në rast të mungesës ose pengimit të tij me kompetenca dhe afate kohore në kohën e duhur të treguar nga Keshilli i Administrimit.

#### **Neni 15 - Vendimet e Keshillit të Administrimit**

15.1. Vendimet e bordit të administrimit merren në mbledhje kolegjiale.

15.2. Votimi nuk mund të jepet me përfaqësim.





## Neni 16 - Mbledhja kolegjiale e Keshillit te Administrimit

16.1. Keshilli i administrimit mblidhet në selinë ose gjetkë, në Shqipëri ose jashtë saj, sa herë që Presidenti e gjykon të nevojshme dhe kur bëhet një kërkesë me shkrim nga të paktën një prej anëtarëve të tij ose nga organi mbikëqyrës, nëse emërohet.

16.2. Si rregull, thirrja do të bëhet me njoftim, të dërguar nga çdo sistem komunikimi, me kusht që të jetë e përshtatshme për të siguruar vërtetimin e marrjes, Administratoreve të paktën shtatë ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen, me përjashtim të rasteve urgjente. Në të cilin mund të kryhet me njoftim të dërguar të paktën tre ditë para mbledhjes.

Brenda të njëjtit afat, njoftimi për thirrjen i jepet organit mbikëqyrës nëse emërohet.

16.3. Keshilli Administrimit në çdo rast është i formuar në mënyrë të vlefshme dhe i aftë të miratojë vendime nëse, edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpërmendura, janë të pranishëm të gjithë anëtarët e vetë bordit dhe të gjithë anëtarët e organit të kontrollit, nëse emërohen, pa paragjykimë në të drejtën e secilit prej të pranishmëve të kundërshtojë diskutimin e temave për të cilat ai nuk e konsideron veten të informuar mjaftueshëm.

16.4. Mbledhjet mund të mbahen edhe nëpërmjet audio-video-konferencës ose audio-konferencës vetëm për sa kohë që sigurohen të drejtat e mëposhtme të pjesëmarrjes: duhet zgjedhur një vend takimi ku të paktën Presidenti dhe Sekretari i mbledhjes janë të pranishëm, duhet të lejohet identifikimi i saktë i personat që kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhje, secili duhet të lejohet të flasë me gojë për të gjitha çështjet, si dhe të jetë në gjendje të shikojë ose të marrë dokumentacionin dhe të jetë në gjendje ta transmetojë atë. Ekzistenca konkrete e të drejtave të sipërpërmendura të pjesëmarrjes duhet të konstatohet nga Kryetari i mbledhjes, i cili duhet ta njohë atë në procesverbalin përkatës.

16.5. Mënyrat e shprehjes së votës, duke u kuptuar se në çdo rast duhet të jetë një metodë që lejon identifikimin e atyre që votuan kundër ose që abstenojnë, vendosen me shumicën absolute të votave të të pranishmëve.

## Neni 17 - Vendime të marra me mbledhje kolegjiale

17.1 Këshilli administrativ merr vendime të vlefshme me shumicë absolute të votave të anëtarëve të saj; në rast barazie të votave mbizotëron vota e Presidentit.



17.2 Vendimet e këshillit duhet të konstatohen nga verbal i transkriptuar në një libër të posaçëm të mbajtur sipas normave ligjore dhe nënshkruar nga Presidenti dhe sekretari i mbledhjes.

## Neni 18 - Fuqitë e Organit Administrativ

18.1 Ne baze të nenit 95 të ligjit 9901 date 14/04/2008 Organi administrativ është i veshur me fuqitë më të gjera të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrimit, me përjashtim të atyre që ky akt i rezervon si kompetenca ekskluzive të vendimeve të ortakëve. Në rast të emerimit të disa administratoreve, në momentin e emerimit, kompetencat mund t'u atribuohen atyre bashkërisht, ose veçmas ose me shumicë votash, ose disa kompetenca administrative mund t'i atribuohen veçmas dhe të tjera bashkë.

A) Referuar kompetencave që kanë të bëjnë me Presidenten e Këshillit, znj. Meneghin Maria Antonietta, kjo e fundit ka kompetenca të plota të administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, për administrimin e Shoqërisë.

B) Referuar kompetencave të Këshilltarit Z. Nicola Sgamma, i jepen këto fuqi:

-Ndjekjen e mbarevajtjes së aktivitetit të Shoqërisë, ndjekjen e procesit të prodhimit dhe teknik, konsulence teknike.

-Menaxhimin e punonjesve

C) Referuar kompetencave të Administratorit të deleguar Z. Erion Cimo i jepen këto fuqi:

-Kryen funksione operacionale që lidhen me Administrimin e zakonshëm të Shoqërisë.

-Përfaqësimin e shoqërisë në Banka, hapjen e llogarive bankare për Shoqërine, Menaxhimin e arketimeve dhe pagesave të ndryshme.

-Nuk ka të drejte për të kërkuar financime apo kredi në përfaqësi të këtyre fuqive, si dhe të tërheqjeve në bankë.

-Kryerjen dhe nënshkrimin e Kontratave të Punës

-Administrimi financiar i Shoqërisë. Drejtimi i shërbimeve të kontabilitetit, fiskale, dhe tatimore.

-Përfaqësimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Administratës tatimore, Doganes, Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore dhe çdo Institucion tjetër të Administratës Publike.

Administratoret mund të veprojnë veçmas nga njëri -tjetri sipas kompetencave të tyre.

Nëse administrimi i është besuar veçmas disa Administratoreve, në rast kundërshtimi nga një Administrator ndaj operacionit që një tjetër synon të kryejë, ortakët kanë kompetencë të vendosin për kundërshtimin.

18.2 Këshilli i administrimit ose administratori i vetëm do të ketë pra, ndër të tjera, të drejtën për të blerë, shkëmbyer, shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme, automjete, ti përfshijë në shoqëri, të marrë aksione dhe interesa, të marrë dhe obligacione, të emerojë prokurues për akte ose kategori aktesh, drejtorë e cdo gjë tjetër që do të konsiderohet e domosdoshme për qëllimet e shoqërisë. Asambleja e ortakëve ose akti i emërimit të Administratoreve mund të përcaktojë kufirin e vlerës brenda të cilit Administratoret mund të ushtrojnë kompetencën e përfaqësimit të Shoqërisë.

18.3 Në rastin kur shoqëria administrohet nga një Këshill Administrimi, Këshilli mund të delegojë një pjesë ose të gjithë atributet dhe fuqitë e tij dhe ato të Presidentit, përfshirë edhe firmën e shoqërisë, njërit ose disa prej anëtarëve të tij duke mirëpërcaktuar atributet ose penalitetet si edhe shpërblimet në kufijtë dhe format që ai do ta gjykojë të përshtatshme.

#### **Neni 19 - Firma dha përfaqësimi i Shoqërisë**

19.1 Përvec rasteve të parashikuar në artikullin e mëparshëm 18.3, firma dhe përfaqësimi i Shoqërisë, sipas sistemit të zgjedhur takojnë Presidentit të Këshillit Administrativ, Zevendes Presidentit, në rast të mungesës së të parit, Administratoreve të deleguar nga Këshilli; administratorit të vetëm; në rastin e disa Administratoreve, përfaqësimi mund t'u atribuohet atyre bashkë ose veçmas. Përfaqësuesi ligjor mund të emerojë Përfaqësues me negociim.

### **KREU V ORGANI I KONTROLLIT**

#### **Neni 20 - Organi i kontrollit**

20.1 Kontrolli i shoqërisë mund t'i besohet dhe të kryhet sipas zgjedhjes dhe me vendim të asamblese së ortakëve, nga një ekspert kontabël. Eksperti kontabël mund gjithashtu të pushohet nga puna nga asambleja e ortakëve.

### **KREU VI BILANCI - FITIMET**

#### **Neni 21 - Ushtrimi i shoqërisë, bilanci dhe fitimet**

21.1 Ushtrimet e shoqërisë mbyllen më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të cdo viti.

21.2 Bilanci i hartuar në konformitet me normat e pajtërsuara ligjore, duhet tu paraqitet ortakëve për miratim.



21.3 Fitimet neto të rezultuara nga bilanci do të ndahen kështu:

a) 5 % (pesë për qind) në ngritjen e një fond rezerve ligjore, deri në arritjen e një shume të barabartë me një të dhjetën e kapitalit të shoqërisë;

b) fitimi i mbetur i pashpërndarë ose i lënë mënjanë sipas vendimeve të ortakeve që miratojnë pasqyrat financiare.

Në cdo rast, nëse verifikohet humbje kapitali, nuk mund të ketë shpërndarje fitimesh deri kur kapitali i shoqërisë të ri integrohet dhe të kthehet në masën e duhur.

## KREU VII

### SHKRIRJA, PERJASHTIMI I ORTAKEVE, LIKUJDIMI DHE MOSMARRVESHJET

#### Neni 22 - Shkrirja

22.1 Shoqëria quhet e shkrirë vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

22.2 Në cdo rast shkrirje të shoqërisë, ortakët do të përcaktojnë një ose më shumë likujdues dhe do caktojnë fuqitë dhe shpërblimin e tyre.

#### Neni 23 - Dispozita të përgjithshme


23.1 Për gjithcka që nuk është shprehimisht e parashikuar në aktin e themelimit ose në këtë statut, do të bëhet kohë pas kohe një referim i shprehur i ligjeve në fuqi.

## ORTAKU I SHOQERISE

Shoqëria "CALZATURIFICIO ORION S.P.A."

Perfaqesuar nga

Meneghin Maria Antonietta




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER FLORIAN F. HOXHA



V202301171002543924

DATE 30/03/2023  
NR REP 460



VËRTETIM NËNSHKRIMI


Sot, më datë 30/03/ 2023 (Dymije e njezet e tre), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT: MARIA ANTONIETTA MENEGHIN**, atësia CESARE, amësia MARIA FAVERO, shtetas Shqiptar, lindur në ARZERGRANDE dhe banues në ITALIA, me adresë Via Madonna 9- Terrassa Padova, lindur më 27/05/1952, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. CA00227DC dhe nr. personal CA00227DC ne cilesine e perfaqesueses ligjore te Shoqerise "CALZATURIFICIO ORION" S.P.A. me qender ne Via Industria, 4-35023 Bagnoli di Sopra(PD). me kod fiskal dhe Nr. regjistrimi ne Regjistrin e Shoqerive ne Padova (PD) me NIPT 02018450284, REA PD-197834.

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruan përpara meje Noterit ne prezence te perkthyesit te gjuhes italiane Arda Grucka, "Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise ORIALBA shpk", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
FLORIAN F. HOXHA



ATTO DI COSTITUZIONE

Per la creazione della Società a Responsabilità Limitata

**"ORIALBA" shpk**

In data odierna 30/03/2023 è comparso davanti a me Notaio Florian Hoxha, membro della Camera Nazionale Notarile, Filiale Locale di Durazzo, con Ufficio Notarile nell'indirizzo Durazzo, Nr.11, "Aleksander Goga", Nr.641, Nr.27 :

- **Sig.ra Meneghin Maria Antonietta**, Cittadina italiana, nata il 27/05/1952 a Arzergrande (PD) - Italia e residente in Via Madonna 9 - Terrassa Padovana (PD) - Italia con carta di identità italiana Nr. CA00227DC, in qualità del Rappresentante legale della Società **"CALZATURIFICIO ORION S.P.A."** con sede in Via Industria, 4-35023 Bagnoli di Sopra (PD), con Capitale Sociale Euro **1.000.000**, con codice Fiscale dhe Nr. di Registrazione nel registro delle Imprese di Padova (PD) no. **02018450284**, REA PD-197834;

Detta Signora mi dichiara che ha deciso di costituire la società a responsabilità limitata **"ORIALBA" shpk** come segue:

**Articolo 1**

Il soggetto sopracitato, di propria libera volontà e in piena libertà in base alle leggi Albanesi, costituisce la società a responsabilità limitata (s.r.l) denominata **"ORIALBA" shpk**.

- La società sarà amministrata da un consiglio di amministrazione composto da tre amministratori:
  - a) **Dalla Sig.ra Meneghin Maria Antonietta**, nata il 27/05/1952 a Arzergrande (PD) - Italia e residente in Via Madonna 9 - Terrassa Padovana (PD) - Italia con carta di identità italiana Nr. CA00227DC, che viene nominata **Presidente del consiglio di amministrazione** per un periodo di 5 anni;
  - b) **Dal Sig. Nicola Sgamma**, nato il 25.11.1960, a Barletta-Italia residente in Vlore Via 28 Nentori, con carta di identità italiana Nr. AT9646354, che viene nominato **Consigliere del Consiglio di amministrazione** per un periodo di 5 anni

c) Dal Sig. Erion Çimo, nato il 15.06.1980, nato e residente in Durazzo con Carta di identità Nr. I00615073N, che viene nominato **Amministratore delegato** per un periodo di 5 anni

d)

La società ha il diritto di creare filiali dentro e fuori dal paese in qualunque momento venga ritenuto opportuno, con l'approvazione degli organi competenti (Centro Nazionale di Registrazione).

## Articolo 2

La società gode dello stato di persona giuridica. La sua attività si svolgerà secondo i punti disposti su questo atto costitutivo, il suo statuto e le leggi in vigore.

La sua sede è: DURRES, Lagjja 15, Spitalë, Kapanon 1 katësh, Zona Kadastrale 8514, Nr.Pasurie 104/14

Lo statuto della società si allega a questo atto di costituzione e ne è parte integrante.

## Articolo 3

L'attività della società come persona giuridica ha inizio con la registrazione dell'atto costitutivo da parte degli organi competenti dello Stato e proseguirà per la durata di oltre 10 anni, salvo anticipato scioglimento o proroga.

## Articolo 4

La società ha come oggetto:

Produzione di calzature e di parti di calzature di qualsiasi tipo (Sportive, da passeggio, da riposo, ortopediche, Ecc) e di qualsiasi materiale (Cuoio, pelle, plastica, gomma, feltro, ecc.) nonché elementi accessori alle stesse;

